




**Për:** Agjencia Kundër Korrupsionit – Drejtori, Shaip Havolli  
**Nga:** Zyra Ligjore e BIRN dhe Internews Kosova  
**Re:** Informacion lidhur me ushtrimin e kundërligjshëm të funksionit të lartë në ndërmarrje publike të zyrtarit Sejdi Hoxha  
Prishtinë, 22 maj 2019



I nderuari z. Havolli,

Ju drejtohem në emër të Zyrës Ligjore të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese – BIRN dhe Internews Kosova në lidhje me dyshimet për ushtrimin e kundërligjshëm të funksionit të lartë në ndërmarrje publike të zyrtarit Sejdi Hoxha.


Zyra Ligjore e BIRN dhe Internews Kosova, konsideron se Sejdi Hoxha, ushtron funksionin e Kryeshefit të ndërmarrjes publike “Posta e Kosovës sh.a” dhe të njejtën kohë, mbanë funksionin e lartë në Partinë Demokratike të Kosovës, si Kryetar i degës së kësaj partie në Komunën e Drenasit kundërligjshëm.

Në zgjedhjet e brendshme të degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Drenas, kandidati Sejdi Hoxha është zgjedhur kryetar i kësaj dege. Në të njejtën kohë, Sejdi Hoxha ushtron funksionin e Kryeshefit të ndërmarrjes publike “Posta e Kosovës sh.a”.

Më konkretisht është shkelur neni 21, paragrafi 4, i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike<sup>1</sup>, i cili përcakton se:

“Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar si zyrtarë të jenë person me integritet të njohur të cilët (i) i plotësojë kushtet e kualifikimit sipas Nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) dhe (iii) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; (theks i shtuar)

<sup>1</sup> Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qasur në Gazetën Zyrtare: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>



Ndërkaq sipas Nenit 17, paragrafi 1 (k) të këtij ligji (përfshirë në Ligjin Nr. 04/L-111 për Plotësim-Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike<sup>2</sup>), kriter i pavarësisë është që Kryeshefi Ekzekutiv të mos:

k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) **bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;** (theks i shtuar)

Pretendimin tonë e bazojmë edhe në një opinion ligjor të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, të datës 21 shtator 2018, në lidhje me procesin e rekrutimit për Kryeshef Ekzekutiv të ndërmarrjes publike "Korporata Energjetike e Kosovës sh.a."

MZHE, përmes këtij opinion ligjor ka trajtuar problemin e pavarësisë politike të kandidatëve për Kryeshef Ekzekutiv të ndërmarrjes "KEK sh.a.", dhe konfliktit mes Nenit 17 dhe 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.


Sipas këtij opinion ligjor, që është zbatuar në rastin e rekrutimit të Kryeshefit Ekzekutiv të "KEK sh.a.", "**personi që është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike**", nuk mund të zgjidhet Kryeshefit Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike"<sup>3</sup>. (theks i shtuar)

Zyra Ligjore e BIRN dhe Internews Kosova argumenton se ngjashëm, si në rastin e Kryeshefit të KEK, Agjencia Kundër Korrupsion duhet të zbatoj kriteret sipas leximit të Nenit 21, par.4 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe konsideroj të kundërligjshëm ushtrimin e funksionit të Kryeshefit të "Postës së Kosovës sh.a." nga ana e Sejdi Hoxhës, sepse i njejtë është bartës i postit udhëheqës dhe vendimmarrës në Partinë Demokratike të Kosovës.

Tutje, ne argumentojmë që dispozitat në lidhje me kriteret për emërimin e Kryeshefit të mishëruara në Nenin 17, par. 1 (k) duhet të aplikohen edhe në rastet kur pas emërimit paraqiten rrethana faktike apo juridike të cilat janë në kundërshtim me kriteret për pavarësi, të mishëruara në këtë dispozitë të Ligjit për Ndërmarrje Publike. Ndryshe, kriteret për pavarësi të kandidatëve që konkurojnë për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv nuk do të kishin asnjë

<sup>2</sup> Ligji Nr. 04/L-111 për Plotësim-Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qasur në Gazetën Zyrtare: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

<sup>3</sup> Opinioni Ligjor i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, i datës 21 shtator 2018.



kuptim, nëse pas përzgjedhjes si Kryeshef Ekzekutiv, këto kritere nuk vazhdojnë të respektohen.

Në fund, Zyra Ligjore e BIRN dhe Internews Kosova argumenton që është në kompetencën e AKK-së të hetoj këtë rast, duke u bazuar edhe në opinione të mëherëshme të Agjencisë. Agjencia Kundër Korrupsionit, në një opinion drejtuar Zyrës së Kryeministrit të datës 15 shkurt 2016, ka gjetur shkelje të ngjashme. Sipas këtij opinioni, ishin vërejtur emërime të personave që kanë ushtruar poste publike apo kanë qenë të emëruar apo kandiduar nga subjektet politike për poste publike<sup>4</sup>.

Andaj, Zyra Ligjore e BIRN kërkon nga AKK, që konform Nenit 5, par. 1, pika 1.12 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Nenit 22, par. 1, pika 5, Nenit 22, par. 4, 8, 9 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, të hetoni dyshimet e ngritura më lartë.

Nëse keni ndonjë pyetje ose kërkesë, ju lusim të mos hezitoni të na kontaktoni. Gjithashtu ju lusim që në rastin e marrjes së çfarëdo vendimi në lidhje me rastin në fjalë – të na kontaktoni përmes email adresës: [arberkadriu@jetanekosove.com](mailto:arberkadriu@jetanekosove.com), ose përmes postës në koordinatat e shënuara më poshtë.

Sinqerisht,

Arbër Kadriu

Zyra Ligjore e BIRN dhe Internews Kosova

<sup>4</sup> Opinion i AKK-së, i datës 15 shkurt 2016, qasur në: [https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Opinionet/01-681-16-dlk-Opinion\\_ZKM\\_66368.pdf](https://www.akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Opinionet/01-681-16-dlk-Opinion_ZKM_66368.pdf)